



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

EDICIONI I KATËRT BULETINI INFORMATIV



4 European
Union
Kosovo





AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

AUTORITETI I KONKURENCËS GJATË VITIT 2020





FJALA E KRYETARIT: VITI I ZHVILLIMIT LEGJISLATIV DHE RASTEVE TË MËDHA

Viti që po e lëmë pas ka qenë një nga vitet më sfiduese për të gjithë ne për shkak të përhapjes së pandemisë COVID-19. Sidoqoftë, gjatë këtij viti, ne në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës kemi arsye për t'u ndjerë krenarë për punën dhe sukseset e arritura.

Në fakt, nëse do të më duhej ta përmbledhja të gjithë punën e bërë me pak fjalë, do të thosha se ky ka qenë viti i rasteve të mëdha të trajtuar nga AKK dhe i përparimit të dukshëm në kompletimin e legjislacionit të konkurrencës bazuar në standardet më të mira të Bashkimit Evropian.

Në veçanti, vendimi për rastin e njohur si “Rasti Nafta” – një vendim i cili ka shqiptuar dënime administrative në vlerë mbi 4 milionë euro për kompanitë e derivateve të naftës të cilat kanë shkelur Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës – ka treguar që Autoriteti i Konkurrencës gëzon kapacitetet e nevojshme profesionale për të trajtuar raste mjaft komplekse.

Ne tashmë e kemi përfunduar draftimin e Ligjit të ri për Mbrojtjen e Konkurrencës. Ky projektligj - i cili është hartuar me përkrahjen e ekspertëve me përvojë ndërkombëtare - I garanton kompetenca e përgjegjësi më të gjera AKK-së. Ligji por edhe Strategjia e AKK-së për vitet 2020-2023, e miratuar vitin e kaluar, përbëjnë bazë të shkëlqyeshme për punën tonë për vitet e ardhshme.

Gjatë këtij viti i kemi kushtuar rëndësi edhe avokimit për politika të konkurrencës, duke nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me institucione të ndryshme, duke takuar përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të biznesit dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Fokus i rëndësishëm i është kushtuar edhe trajnimit të mëtejshëm të stafit, me mbajtjen e një numri të konsiderueshëm të trajnimeve me ekspertë të dëshmuar ndërkombëtare e vendor në fushën e konkurrencës.

Natyrisht, ka gjithëherë hapësirë për të bërë më shumë. Por, viti që po e lëmë pas më inkurajon të besoj se edhe gjatë vitit 2021 do të jemi në krye të detyrës për të siguruar një treg me mundësi të barabarta për të gjithë operatorët, si garantues për përfitime të gjithanshme ekonomike, si dhe të rrisim tutje kapacitetet tona.

Valon Prestreshi

Kryetar i Autoritetit
Kosovar të Konkurrencës

AKTIVITETET MË TË SHPESHTA TË AKK-SË GJATË 2020



21 korrik 2020: Një nga ngjarjet e zhvilluara me zyrtarët e Autoritetit gjatë këtij viti



Në foto (nga e majta):

Sakip Imeri, Drejtor i Përgjithshëm, Ahmet Krasniqi, Nënkyetar, Valon Prestreeshi, Kryetar, Fatime Haziri, Komisionere

SHËNOHET PËRPARIM PËRMBAJTËSOR PËR LIGJIN E RI TË KONKURRENCËS

Pas përfundimit të thujtse të gjithë legjislacionit sekondar si dhe miratimit të Strategjisë për vitet 2020-2023, prioritet i Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2020 ka qenë hartimi i Ligjit të ri për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Një Grup Punues i përbërë nga ministri të linjës, zyrtarë të AKK-së por edhe ekspertë ndërkombëtarë, kanë punuar në pjesën më të madhe të këtij viti për të hartuar një draft të këtij ligji.

Drafti i ri është në fazën e dëgjimit publik dhe pas përfundimit të këtyre procedurave, i është dërguar Qeverisë së Kosovës për aprovim. Qeveria e Kosovës e kishte paraparë Ligjin e ri të Konkurrencës në planin e vet legjislativ kohë më parë.

Ligji ri i Konkurrencës është hartuar bazuar në praktikat më të mirë të legjislacionit të konkurrencës në Bashkimin Evropian dhe do të jetë në përputhje të plotë me Acquis të BE-së. Ky ligj do t'i garantojë AKK-së mandat më të gjerë dhe do të kontribuojë në përmirësimin e konkurrencës në vend.

Fillimisht, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është miratuar më 2010 nga Kuvendi i Kosovës ndërsa në vitin 2014 ky ligj është plotësuar për t'i mundësuar më shumë fuqi AKK-së.



DISA NGA RASTET MË TË MËDHA TË TRAJTUARA GJATË 2020

Viti 2020 për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës është karakterizuar me trajtimin dhe marrjen e vendimeve për disa raste komplekse dhe të mëdha.

Në muajin prill, AKK ka marrë një vendim për shqiptimin e masës ndëshkuese administrative ndaj 14 kompanive të derivateve të naftës në vlerë prej mbi 4 milionë euro.

Ky përbën dënimin më të lartë të shqiptuar nga AKK që nga themelimi i tij.

Këto kompani të naftës janë gjobitur për çrregullim e konkurrencën në treg gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, kur ishin ngritur dyshime se operatorët e shitjes me pakicë të derivateve të naftës nuk kishin reflektuar në mënyrë individuale me rastin e caktimit të çmimeve. Atë kohë, çmimi i derivateve në tregun e Kosovës kishte mbetur i njëjtë përkundër uljes së çmimit në berzën ndërkombëtare.

Një rast tjetër i rëndësishëm i filluar nga AKK në muajin dhjetor ka të bëjë me hetimin ndaj ndërmarrjeve KEDS dhe KESCO, të cilat operojnë në tregun e energjisë.

Këto ndërmarrje dyshohet se kanë bërë marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar dhe abuzim me pozitën dominuese në treg, duke shkelur Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.



ANGAZHIMI I AKK-SË PËR TREGJE FUNKSIONALE GJATË PANDEMISË

Funksionimi i tregjeve në Kosovë që nga fillimi i përhapjes së pandemisë COVID-19 ka qenë prioriteti kryesor i AKK-së.

Për të arritur një funksionalitet të tregjeve, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë një rol aktiv që nga java e parë e përhapjes së virusit, në mënyrë që të evitohet çfarëdo shkelje e mundshme e konkurrencës, apo që të evitohet keqpërdorim i situatës për profit nga ana e operatorëve të tregjeve relevante.

Marrë parasysh se AKK është një institucion i ri, përveç hetimeve intensive, një fokus i rëndësishëm i është kushtuar edhe avokimit për politika të konkurrencës gjatë kësaj kohe. Në fillim të muajit mars, Kryetari i AKK-së, Valon Prestreshi, ishte emëruar në Komisionin e Posaçëm për parandalimin e pandemisë të krijuar nga Qeveria e Kosovës.

Vetëm pak javë më vonë, pas hetimeve në disa tregje relevante, AKK ka arritur të identifikojë shkelje të konkurrencës gjatë shitjes së dezinfektuesve dhe alkoolit për përdorim mjekësor.

Kurse, që nga muaji gusht, kur autoritetet vendosën të licencojnë numër të madh të laboratorëve privatë, AKK e ka mbikëqyrur sistematikisht sjelljen e operatorëve të këtij tregu.

Pas analizave të bëra nga AKK, është konstatuar se ky treg - por edhe tregjet e tjera – kanë funksionuar mirë, që nënkupton ka pasur liberalizim të tregut, ku janë ofruar produkte me çmime të ndryshme dhe nuk janë evidentuar shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Gjithashtu, AKK ka zhvilluar një fushatë vetëdijesuese, që përfshinë publikimin e një videoje informuese, qasje aktive në rrjetet sociale dhe bashkëpunim të ngushtë me media.



AVOKIMI PËR POLITIKA TË KONKURRENCËS DHE MEMORANDUME BASHKËPUNIMI

Gjatë këtij viti, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kishte planifikuar zhvillimin e një fushate intensive vetëdijësuese për politikatat e konkurrencës dhe rolin e AKK-së.

Kjo fushatë ishte paraparë të përkrahej nga Projekti i BE-së “Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore”, përfitues kryesor i të cilit është AKK. Por, për shkak të pandemisë, kjo kampanjë është shtyrë për vitin tjetër.

Përkundër kësaj, AKK ka zhvilluar një numër aktivitete për të avokuar për misionin e tij dhe politikatat e konkurrencës në përgjithësi.

Në muajin mars, AKK kishte publikuar një video informuese për rolin e AKK-së si rregullator i tregut ndërsa ka zhvillua takime të drejtpërdrejta me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, përfshirë këtu përfaqësuesit e Shoqatës së Institucioneve Financiare Jobankare, përfaqësues të laboratorëve privatë, përfaqësues të Shitësve me Pakicë, vizita në kompani të ndryshme e të tjera.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është bashkëpunimi me rregullatorë të tjerë për forcimin e zbatimit të konkurrencës. Gjatë vitit 2020, AKK ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës.

Kjo marrëveshje ndër të tjerash i mundëson AKK-së që të kërkojë ndihmën e Policisë së Kosovës për të kryer “bastisje të mëngjesit” tek kompanitë e dyshuara për shkelje të ligji të konkurrencës.

Një memorandum tjetër është nënshkruar me Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Gjithashtu, gjatë këtij viti, AKK ka publikuar edhe dy Mendime Profesionale për institucionet e Kosovës që janë në funksion të zbatimit të konkurrencës në fusha specifike.




TRAJNIME, KONFERENCA DHE PUNËTORI

Si përfitues i Projektit Mbështetja e BE-së për Autoritetin e Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore, AKK ka mbajtur një numër trajnimesh dhe punëtorish për stafin në fusha të ndryshme që lidhen me politikat e konkurrencës.

Gjatë këtij viti janë mbajtur pesë trajnime disaditore për tema të ndryshme për zbatimin efektiv të konkurrencës si dhe disa punëtori të tjera, ku kanë marrë pjesë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Disa nga trajnimet e zhvilluara përfshijnë: trajnim dy-ditor rreth metodave dhe mjeteve ekonomike për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës; trajnimi mbi aspektet ligjore të hetimit dhe vendimmarrjes në zbatimin e konkurrencës; trajnim për identifikimin e manipulimit të ofertave si një praktikë specifike kundër konkurrencës, e të tjera.

Gjithashtu, stafi i AKK-së ka marrë pjesë edhe në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, siç janë Seminari për Reagimin në Koha krize me politika të konkurrencës më 1 dhe 2 korrik; webinarin Politikat dhe Ligji i Konkurrencës pas pandemisë COVID-19 të organizuar nga Autoriteti Turk i Konkurrencës më 16 qershor; ëëbinari për Luftimin e Karteleve Ndër-kufitare përmes bashkëpunim ndërkombëtar në kohë krizash të mbajtur më 2 korrik e të tjera



ORGANOGRAM

Komisioni i AKK-së

Drejtori i Përgjithshëm

**Dep. Juridik dhe
Administratës**

Dep. i mbikqyrjës së tregut

Zyrtar i lartë
Ligjor

Zyrtar i lartë për
Buxhet dhe Financa

Zyrtar i lartë i
Personelit

Asistenti
ekzekutiv

Zyrtari i Logjistikës
Vozitësi

**Divizioni i
Pozitës
Domunuese**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Divizioni i
Marrëveshjeve
të Ndaluar**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Divizioni i
Përqendrimeve
e/Bashkimeve**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**D. i Analizës
Metedologjisë
dhe të drejtave
Ekslusive**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**

**Inspektor
Hetues i
Konkurencës**



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



European
Union
Kosovo



Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.